

2 Anketa e Unia në gastronomi e hoteleri
Të punësuarit përballen me abuzime të ndryshme

3 Kërkesat e Konferencës së Migracionit të Unia
Të punësuarit të mbrohen nga racizmi!

4 Konferenca «Diaspora Flet» 2023 në Prishtinë
Është koha të bashkë-krijojmë!

Nr. 4 | Qershor 2023 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Nisma popullore për një të drejtë natyralizimi modern

Çka dëshiron nisma për demokraci?



Pamje nga punimet e Komitetit nismëtar, i cili përbëhet nga politikanë dhe nga nga njerëz të shoqërisë civile

Më 23 maj është nisur nga shoqata «Vierviertel» (katër të katërtat) përmes një konference për media nisma për demokraci. Komiteti nismëtar përbëhet nga njerëz të shoqërisë civile me sfond të ndryshëm, nga të cilët po veçojmë Paul Rechsteiner, Arbër Bullakaj, Hilmi Gashi, Tarek Naguib, Emine Saraslan. Një çerek e popullatës zvicerane jeton në Zvicër, punon dhe paguan taksat, ka miq e familje – mirëpo nuk posedon pasaportën zvicerane. Është koha që këtë njerëz të njihen si anëtarë të barabartë të shoqërisë dhe që atyre tu mundësohet pjesëmarrje e plotë politike dhe shoqërore!

Emine Saraslan

Rruga për këtë është natyralizimi: ai garanton të drejtën e pjesëmarrjes në zgjedhje dhe votime, në një qëndrim të sigurtë dhe të pakushtëzuar si dhe njohja si pjesëtar i barasvlershëm i shoqërisë. Mirëpo Zvicra sot në Evropë ka legjislacionin më restriktiv të natyralizimit. Hendeqet janë shumë të mëdha, fjala bie afatet komunale e kantonale të banimit, kostoja prej disa mijëra frangave, ose fakti, që pjesërisht kandidati për natyralizim duhet të prezantohet para kuvendit komunal. Derisa sot kantonet dhe komunat përtej ligjit federal mund të përcaktojnë parakushtet për marrjen e shtetësisë, për natyralizim kërkohet plotësimi i kriterëve të ndryshme shpesh subjektive dhe lokale.

Procedurat e natyralizimit të harmonizohen sipas kriterëve objektive

Andaj nisma për demokracinë dëshiron që procedurat e natyralizimit të harmonizohen sipas kriterëve objektive. Kushdo që për 5 vite jeton rregullisht në Zvicër, duhet të mund të shtrojë një kërkesë për fitimin e shtetësisë. Kjo duhet të shqyrtohet vetëm bazuar në kriteret objektive. Kushdo që plotëson këto kriteret të ketë të drejtën e marrjes së shtetësisë zvicerane.

Kriteret vijuese duhet të qojnë në fitimin e të drejtës së shtetësisë zvicerane:

- Personi duhet në mënyrë të ligjshme të jetë banor së paku 5 vite në Zvicër.
- Personi nuk duhet të jetë i dënuar me privim lirie afatgjate.
- Personi nuk guxon të rrezikojë sigurinë e brendshme dhe të jashtme të Zvicrës. Ky kriter vlen edhe tani dhe duhet të vazhdojë të vlejë më tej.
- Personi duhet të dëshmojë njohuri themelore (A2) të një gjuhe vendore. Kjo është në përputhje me kornizat e përbashkëta referuese evropiane.

Shtetësia zvicerane nuk duhet të jepet automatikisht përmes nismës për demokraci. Personi përkatës duhet ashtu sikur vlen edhe tani, që të shtrojë një kërkesë për natyralizim tek autoritetet kompetente. Dhënia e shtetësisë pason sikur edhe më parë përmes tri shkallëve: komunës, kantonit dhe federatës, nëse janë plotësuar kriteret objektive.


Pjesëmarrja është një gur themeli i demokracisë

Kush u nënshtrohet ligjeve, duhet të mund të bashkëvendosin mbi to. Mirëpo në Zvicër kjo e drejtë u mohohet një çereku të popullsisë, edhe pse këta njerëz përditë kontribuojnë për jetën ekonomike, kulturore dhe shoqërore. Një qasje e thjeshtëzuar dhe e shpejtë për marrjen e shtetësisë mundëson pjesëmarrjen për të gjithë dhe krijon parakushtet për një demokraci të gjallë dhe moderne.

Ne kemi nevojë për mbështetjen tënde

Që nisma popullore «për një natyralizim modern» të arrijë në votim, ne kemi nevojë për 100 000 nënshkrime. Nënshkrime mund të grumbullojnë të gjithë. Të nënshkruajnë munden vetëm personat me shtetësi zvicerane. Formularët e nënshkrimeve ti mund ti shkarkosh këtu: <https://shorturl.at/myHSZ>. Çdo nënshkrim ka vlerën e vet dhe ndihmon!

Editorial



Migracioni është pjesë e historisë njerëzore. Vendet ku migrohet përfillojnë nga aftësitë profesionale, nga dija, shpirti ndërmarrës dhe talenti e migrantëve. Ekonomia, kultura, shkenca, sporti funksionojnë fuqishëm falë migrantëve. Po ashtu edhe Zvicra. Kjo është dukshëm e qartë. Megjithatë ne jetojmë në një paradoks. Edhe pse puna e migrantëve nevojitet urgjentisht, megjithatë ata nuk i kanë të drejtat e njëta sikur ata me pasaportë zvicerane, fjala bie nëse ata marrin ndihma sociale, rrezikojnë të humbin të drejtat e qëndrimit. Ata paguajnë tatimet, mirëpo nuk mund të bashkëvendosin për përdorimin e tyre. Kjo krijon një shoqëri jo solidarë. Partitë e djathta, posaçërisht SVP/UDC dhe shtytës-mbajtësit e tyre në politikë, administratë etj. përçarjen në «ne» kundër «të tjerëve» dhe përgatisin kështu terrenin për mendësi raciste. Bazuar në raportin e fundit të rrjetit të këshillimoreve kundër racizmit, njerëzit që perceptohen si «të tjerë» qoftë në punë, në shkollim e në administratë, për shkaqe raciste përjetojnë diskriminimin më të madh. Shifra të frikshme kur dihet se ato janë fusha të rëndësishme të jetës së përditshme dhe jo vetëm: janë lëmi të shërbimeve publike, në të cilat shteti ka një rol dhe ndikim të rëndësishëm. Këtu nevojiten strategji të qarta kundër racizmit dhe diskriminimit. Gjithashtu nevojitet një ballafaqim shoqëror, për të pranuar migrantët si qytetar të barasvlershëm. Jo vetëm për ti ngarkuar me detyrime, por edhe për të mundësuar të drejta. Një shoqëri gjithëpërfshirëse është e mundur. Të angazhohemi të gjithë për të!

Hilmi Gashi

News

«Shtëpi dinjiteti për të gjithë të punësuarit shtëpiak në Evropë»

Megjithëse punëtorët shtëpiak përfaqësojnë një fuqi punëtore të madhe dhe jetike, kontributi i tyre ekonomik dhe social shpesh është mohuar dhe ata dëshirojnë njohjen. Bashkimi i Sindikatave Evropiane nga fusha ushqimore, bujqësore dhe e turizmit si dhe sektorëve të përafërt (EFFAT) është i vetëdijshëm, që të punësuarit shtëpiak, 90% nga të cilët janë migrantë, duhet të mbrohen, andaj në fund të vitit të kaluar nisi një fushatë për përmirësimin e sigurisë dhe mbrojtjes shëndetësore për të punësuarit shtëpiak. Me Kongresin e planifikuar Ndërkombëtar të Punëtorëve Vendorë për këtë vjeshtë, sindikatat në Evropë do të vendosin shëndetin dhe sigurinë në krye të agjendës globale.

Kurset e Mowendo janë të dobishëm për ne!

A jeni lajmëruar sivjet për njërin nga kurset e Mowendo? Ende ka kohë, për tu informuar dhe për tu trajnuar më tej! Politika apo e drejta e migracionit, kurs themelor për personat e besuar, çka duhet ndërmarrë në rast dyshimi për tregtim me njerëz, etj.: Lista e ofertave trajnuar është e gjatë. Ka edhe shumë kurse tematike, shumë nga ta janë falas. Shpërndajeni lajmin, se ka ene vende për trajnime në gjysmë vjetorin e dytë. Që njeriu mund të mbrohet më mirë nëse është i trajnuar, ju nuk duhet të leni t'ju kaloi kjo mundësi. Informacione të mëtejme: www.movendo.ch

Anëtar i ri: HelvetiCA i bashkohet Bashkimit të Sindikatave Zvicerane (BSZ)

Shoqata zvicerane e drejtuesve të kontrollit ajror (HelvetiCA, Swiss Controllers Association) bashkohet Bashkimit të Sindikatave të Zvicrës (BSZ). Delegatët e BSZ-së e kanë aprovuar kërkesën e anëtarësimit. Rreth 600 anëtarët e HelvetiCA janë përgjegjës për sigurinë dhe rendin në qiellin zviceran dhe punojnë kryesisht në regjionin e Gjenevës dhe Cyrihut. BSZ-ja si shoqata më e madhe sindikaliste rritet kështu në 18 anëtarë sindikatash.

Shegertët dhe praktikantët të mbrohen nga ngacimet seksuale

Me kërkesë të komisionit për rini të Bashkimit të Sindikatave të Zvicrës (BSZ) në mbledhjen e delegatëve ka aprovuar rezolutën për mbrojtje nga ngacimet seksuale gjatë aftësimin profesional. Nevojiten më shumë kontrolle, për tu respektuar obligimet e kujdesit të punëdhënësve. Pos tjerash duhet të krijohen vende kontakti e këshillimore për dhunën e seksualizuar dhe ngacimet seksuale, në të cilat të prekurit mund të drejtohen edhe në mënyrë anonime. Karshi diskriminimit dhe dhunës së seksualizuar duhet të mbretërojë një kulturë e tolerancës zero veçanërisht gjatë aftësimin profesional.

Demonstrata nacionale klimatike

Me 30 shtator 2023, në ora 14, në Bernë aleanca klimatike bashkë organizon bashkë me njerëz e organizata të shumta, sindikata deh lëvizje një demonstratë klimatike në sheshin federal të Zvicrës. Natyrisht që edhe Unia është pjesë e kësaj.

Kërkesat e përbashkëta janë:

- Mbrojtje e menjëhershme klimatike
- Drejtësi klimatike
- Shkaktarët e mëdhenj të krizës klimatike duhet të perceptojnë përgjegjësinë e tyre
- Politika më në fund duhet të trajtojë me përparësi krizën klimatike

Rezervo këtë termin edhe ti dhe bëhu pjesë e demonstratës klimatike!



Paga minimale

Dy nisma popullore për pagën minimale në Kantonin Vaud/Waadt

Unia Vaud/Waadt dhe lidhja e rreth 20 organizatave filluan dy nisma popullore për futjen e pagës minimale të detyrueshme prej 23 frangave për orë. Deri në shtator 2023 duhet të grumbullohen 12 000 nënshkrime.

Darinka Filipovic

Të dyja nismat plotësojnë njëra tjetrën: E para dëshiron të fuqizon parimin e pagës minimale në kushtetutën kantonale të Vaud/Waadt, e dyta parashih një ligj me një pagë minimale të detyrueshme prej 23 frangave në orë. Në këtë mënyrë nismëtarët duan të mënjanojnë kohën e gjatë procedurale për miratim përmes votimit, meqenëse për këtë çështje nevojitet veprim urgjent.

Të gjithë duhet të mund të jetojnë nga paga e tyre

Në Kantonin Vaud/Waadt gati 10 përqind e të punësuarve punojnë me paga të ulëta dhe vetëm gati 8 përqind i takojnë kategorisë së varfër të punës. Pagat e ulëta paguhen parasëgjithash në profesionet ku me shumicë punojnë gratë dhe njerëzit me sfond migracioni, si p.sh. në industrinë ushqimore dhe atë prodhuese, në sektorin e pastrimit, në shërbimet personale, apo në hoteleri e gastronomi. Kjo nuk është e pranueshme, pasi të gjithë të punësuarit duhet të mund të jetojnë nga paga e tyre.

Më shumë barazi, integrim më i mirë

Në këtë mënyrë paga minimale nuk do të kontribuojë vetëm për të luftuar varfërinë. Ajo dot të zvogëlojë pabarazinë mes burrave dhe grave dhe do të ndikojë pozitivisht në integrim dhe barazi të njerëzve me sfond migracioni.

Me ndikim sinjalizues përtej regjionit

Paga minimale në Vaud/Waadt është pjesë e një përpjekjeje kombëtare për mbrojtjen e fuqisë blerëse të punonjësve. Pasi që një nismë e parë kantonale e vitit 2011 u refuzua me një dallim të vogël votash, kantonin Vaud/Waadt ka shanse të mira ti bashkëngjitet kantonëve të Gjenevës, Neunburgut, Juras, Bazel-qyteti dhe Tiçino, të cilat tanimë kanë pagën minimale kantonale të detyrueshme.



Pagat e detyrueshme minimale ka shanse edhe në Kantonin Vaud/Waadt

Anketa në gastronomi e hoteleri

Të punësuarit në gastronomi përballen me abuzime

Ngacmime seksuale, mobing, planifikim afatshkurtër pune, shefi gjithmonë pas shpine, gjithashtu edhe jashtë orarit të punës, heqja e pauzave dhe e ditëve të pushimit, paga të ulëta, pabarazi pagash: Një anketë e sindikatës Unia me të punësuarit në gastronomi e hoteleri i qet një hije të keqe kushteve të punës në këtë sektor. Kjo gjendje nuk mund të vazhdojë më tej!

Marie Saulnier Bloch

Rezultate të tmerrshme

Unia në muajin maj i prezantoi rezultatet e anketës, të zhvilluar nga shkurti deri në prill, për të përmbledhur përmasat e problemeve, me të cilat përballen të punësuarit e sektorit në të gjithë Zvicrën. 42% të punësuarve kanë bërë me dije, që gjatë punës kanë qenë viktimat të mobingut dhe 27% kanë përjetuar ngacmime seksuale në vendin e punës. Veçanërisht keq: vetëm çdo i katërti person, që iu janë nënshtruar këtij problemi, ka marrë mbështetje nga shefi i tyre. Tek 40% e rasteve nuk është respektuar afati minimal prej dy javësh.

45% kanë bërë me dije, që nuk kanë mundur të bëjnë pauzën e tyre, edhe pse ajo u është zbritur nga paga e tyre, ndërsa 20% të tyre u janë hequr tërësisht ditët e tyre të pushimit. Përtej kësaj 73% kanë vu në dukje, se nga rasti në rast e deri edhe prore janë penguar edhe jashtë orarit të punës. Sa i përket pagës, kështu 17% e të anketuarve kanë thënë se janë të kënaqur dhe tek këta sipas rregullit është fjala për të punësuarit, që përfitojnë nga paga minimale kantonale.

Propozimet për përmirësimet janë shtruar në tavolinë

Në shkurt 2023 Unia ka dorëzuar manifestin e të punësuarve në gastronomi e hoteleri me mbi 10 000 nënshkrime shoqatës së punëdhënësve «GastroSuisse». Në te, të punësuarit ndër të tjera kërkojnë paga më të mira, planifikim me kohë të punës, pagesën e orëve të planifikuara, të drejtën për të mos qenë i arritshëm jashtë orarit të punës dhe masa efektive e preventive për mbrojtje të punëmarrësve nga ngacimet dhe mobingu. Është koha e fundit, që «GastroSuisse» ti nënshtrorhet përgjegjësisë.



Të punësuarit në hoteleri e gastronomi përballen me ngacime seksuale, mobing, mungesë pauzash të mjaftueshme, pabarazi pagash, etj.

Ju pyesni, Unia përgjigjet

I papunë: A jam i paaftë për ndërmjetësim pune për 6 javë?

Unë nga 1 shtatori 2022 kam mbetur i papunë pa fajin tim, ngase punëdhënësi im më largoi për arsye ekonomike. Në entin për ndërmjetësim pune gjysh gjatë afatit të largimit nga puna më është sugjeruar, që të vizitohet në Francë një kurs të gjuhës frënge, për të rritur shanset e një punësimi të ri. Unë këtë edhe e kam bërë dhe e kam rezervuar një qëndrim 3 mujor për mësim gjuhe. Pasi Enti regjional për ndërmjetësim nuk donte të ma paguante kursin e gjuhës frënge, unë nga 15 tetori jam çregjistruar nga ndërmjetësimi për punësimin. Tani Enti zyrtar kantonal në mënyrë retroaktive për periudhën kohore nga 1 shtatori deri më 15 tetor ma ka hequr aftësinë ndërmjetësuese dhe ka marrë një vendim përkatës. A është kjo e drejtë?

Markus Widmer: Mjerisht po. Gjykata federale në një rast të ngjashëm ka njohur heqjen retroaktive të aftësisë ndërmjetësuese. Arsyetimi: Nëse dikush në një termin të caktuar merre përsipër obligime tjera dhe për këtë arsye për një punësim të ri është në dispozicion vetëm për një kohë të shkurtër, personi që kërkon punë nuk është më i aftë për tu ndërmjetësuar për punë. Enti zyrtar kantonal në vendimin e tij venë në pah, që ju qysh para çregjistrimit tuaj nga 1 shtatori keni rezervuar qëndrimin dhe kështu ju vetëm prej periudhës kohore nga 1 shtatori deri më 15 tetor keni qenë në dispozicion për tregun e punës. Andaj vlerësohet e pamundur, që një punëdhënësi do t'ju punësonte vetëm për rreth 6 javësh. Ne ju këshillojmë që mos të kundërshtoni këtë vendim.

(Work, 28.4.23)

Çka duhet bërë, nëse nuk marrë pagën më tej?

Ndërmarrja, tek e cila unë jam i punësuar, ka lajmëruar falimentimin në muajin prill. Unë kam punuar deri në ditën e fundit, ndërsa që nga fundi i shkurtit nuk kam marrë më pagën time. Që nga hapja e falimentimit jam lajmëruar si i papunë dhe që nga kjo kohë marrë kompensimin nga sigurimi i papunësisë. Mirëpo, si është puna me pagën, që ma ka mbetur borxh ndërmarrja? A kam punuar unë «falas» nga shkurti deri në hapjen e falimentimit?

Marina Wyss: Jo, ju nuk keni punuar falas. Ju mund të lajmëroni pretendimet tuaja për pagat e hapura në procedurën e falimentimit. Punëmarrësit trajtohen të privilegjuar gjatë procedurës së falimentimit. Megjithatë, ju paguheni vetëm nëse ka ende para pasi të kenë përfunduar procedurat e falimentimit. Kërkesat e pagave të papaguara mbulohen gjithashtu nga kompensimi i falimentimit (IE). E drejta e përfitimit nga IE në parim vlen vetëm për punën e kryer. Pasi që ju keni punuar deri në fund të procedurës së falimentimit, kjo nuk do të duhet të krijonte ndonjë problem. IE mbulon kërkesat e pagave deri më së shumti 4 muaj. Pasi që për lajmërimin tek IE vlen afati prej 60 ditësh, ju këshillojmë që të formuluarin përkatës pa vonesë ta dërgoni tek Arka përgjegjëse publike e papunësisë. Këtë formular e gjeni në vegën vijuese: www.arbeit.swiss/secoalv/de/home/menue/unternehmen/versicherungsleistungen/insolvenz1.html

(Work, 9.5.23)

Falimentimi II: A mund të largohem menjëherë pa respektuar afatin?



NËSE NUK MERRNI PAGËN MË TEJ: Nëse ndërmarrja nuk paguan më pagën për punën e kryer, ju mund të largoheni pa paralajmërim nga puna. (Foto: Shutterstock)

Unë në fund të shkurtit kam marrë vetëm një pjesë të pagës sime. Kur unë për ketë e pyeta shëfën time, ajo më tha se për momentin kishte vështirësi pagëse. Në fund të marsit unë nuk morra fare pagë. Në prill kam punuar më tej, por i thash shëfës sime që unë nuk mund të jetoja pa pagë. Ajo u përgjigj se së shpejti do ti duhej të lajmëroni falimentimin. Tanimë unë kam gjetur një vend të ri pune dhe dua të menjëherë në ndërroj vendin e punës. A lejohet që në këtë rast unë menjëherë të përfundojë marrëdhënien e punës?

Marina Wyss: Po, mirëpo ju duhet paraprakisht të informoni me shkrim punëdhënësin tuaj të tanishme, që ju asaj ia caktoni në afat të «arsyeshëm» me kërcënimin, se do të përfundoni menjëherë marrëdhënien e punës, nëse punëdhënësi brenda afatit të caktuar juve nuk ju siguron se do tua paguajë pagën aktuale dhe atë të ardhshme. Ju keni mundësinë që punëdhënësi të kërkonin pagat e hapura edhe përmes zyrës përmbareuse. Nëse e përfundoni marrëdhënien e punës pa paralajmërim, kjo gjithashtu domethënë, se ju pas hapjes së falimentimit nga punëdhënësi e vjetër mund të kërkonin vetëm pagat e mbetura borxh nga shkurti deri në kohën e përfundimit të marrëdhënies së punës. Andaj këshilloheni urgjentisht, që në rast të falimentimit të mos përfundoni pa paralajmërim marrëdhënien e punës, nëse nuk posedohet një zgjidhje e mëtejme. Të gjithë punonjësit, të cilët janë të prekur nga një falimentim ndërmarrjeje, duhet të këshillohen nga Unia apo nga sigurimi i papunësisë.

(Work, 9.5.23)

Premiera zvicerane në Lucern

Ylfete Fanaj, shqiptarja e parë në një qeveri kantonale të Zvicrës



Ylfete Fanaj është e lindur me 11 korrik 1982 në Prizrenin historik dhe në vitin 1991 i bashkohet familjes së saj në Zvicër, ku njihet si politikanja e parë me prejardhje shqiptare, që kishte fituar më 2007 një mandat si asambleiste e qytetit Lucern dhe më 2011 si

deputete kantonale, pas Osman Osmanit, i cili në zgjedhjet e vitit 2005 ishte shqiptari i parë i zgjedhur si deputet kantonal në Zvicër, po nga Partia Socialdemokrate në parlamentin kantonal të Shafhausenit.

Pas shkollimit të rregullt, ajo më 2009 përfundoi studimet për punë sociale në Shkollën e Lartë të Lucernit. Karrierën politike Ylfetja e ka filluar në organizatën «Secondos», ku ka ushtruar edhe funksionin e anëtares së kryesisë. Ajo ndër të tjera është angazhuar dhe ka vepruar aktivisht edhe në shumë shoqata të ndryshme solidariteti e komunitetesh. Ylfetja si politikanë socialdemokrate ishte edhe kandidatë për parlamentin nacional të Zvicrës në zgjedhjet e vitit 2011, 2015 dhe 2019, pa arritur të fitoj ulësen.

Ylfetja është gjithashtu politikanë e parë me prejardhje shqiptare e zgjedhur në funksion të kryetares së një parlamenti kantonal në periudhën kohore 2020/21. Një punë të cilën ajo e ka kryer me shumë përkushtim dhe kreativitet të madh.

Me 14 maj 2023 Ylfete Fanaj me 45 053 vota u zgjodh në këshillin qeveritar (ministre) në kantonin e Lucernit, duke shënuar kështu një arritje të meritueshme historike për komunitetin tonë në Zvicër.

Suksesi i Ylfetes shënon të arritura në tri rrafshë

Fitorja e Ylfetes Fanaj paraqet një fitore dhe të arritur në tri rrafshë: si pjesëtare e një komuniteti migrantësh, të stigmatizuar me vite e dekada të tëra, siç ishin shqiptarët; si grua në ekzekutiv duke pasur parasysh nën përfaqësimin dhe mungesën e barazisë gjinore edhe në shoqërinë zvicerane; rikthim të socialdemokratëve pas 8 vitesh në qeverisjen kantonale në Lucern.

Fitorja dhe sukseset politike të Ylfetes nuk ka ardhur vetvetiu, por është rezultat i punës së saj të shumanshme e me një përkushtim të madh dhe një politike përfshirëse për të gjithë, që si e tillë duhet të shërbejë si shembull dhe inkurajim për numrin e madh të grave dhe burrave (shqiptaro-zviceran) të angazhuar në jetën shoqërore e politike në Zvicër.

Sindikalistët shqiptaro-zviceran dhe e veprimtarët e së majtës shqiptaro-zvicerane i urojnë përzemërsisht fitoren Ylfetes, fitore ko që e konsiderojnë dhe si të tyren. Këto të arritura si kjo fitore na fuqizojnë edhe si komunitet, fuqizojnë luftën për barazi gjinore, dhe angazhimin për një shoqëri solidare dhe sociale. Bashkë jemi edhe më të fortë dhe mund të kontribuojmë edhe më shumë si për një shoqëri përparimtare, sociale dhe më gjithëpërfshirëse si në Zvicër ashtu edhe si shembull për shtetet amë!

prointegra.ch

Konferenca «Diaspora Flet» 2023 në Prishtinë

Është koha që të bashkë-krijojmë!

Me 18, 19 dhe 20 Maj 2023 u zhvillua konferenca e organizuar nga GERMIN që synonte të forcojnë dialogun ndërmjet anëtarëve të diasporës, politikë-bërësve, shoqërisë civile dhe komunitetit të biznesit nga vendet amë, lidhur me temat kyçe si: fuqizimi i të rinjve dhe adresimi i emigrimit, të drejtat dhe përfaqësimi politik i diasporës, filantropia, investimet dhe lidhjet e tregut, integrimi gjinor e shumë tema të tjera. Përveç temave të lartpërmendura kishte edhe aktivitete të tjera me synim të lidhjes, rrjetëzimit dhe forcimit të raporteve në mes palëve pjesëmarrëse.

Osman Osmani

Pas fjalës mirëseardhëse të dy bashkë drejtuesve të GERMIN Sihana Bejtullahu dhe Lirim Krasniqi, hapja zyrtare e konferencës u bë nga dy anëtarët e bordit të organizatës Anila Hyka-Smøgrav dhe Avni Mustafaj, të cilët përshëndetën pjesëmarrësit dhe ftuan ata për bashkë-krijim gjatë konferencës.

Në ditën e parë folësj kryesore e nderit ishte presidentja e Republikës së Kosovës, Dr. Vjosa Osmani-Sadriu, e cila vlerësoi se diaspora jonë është një aset shumë i çmuar dhe pjesa më e bukur e jona si komb. Ajo theksoi mbështetjen socio-ekonomike dhe politike të diasporës në etapa të ndryshme historike.

Ndërsa në ditën e dytë, folës kryesor ishte kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, i cili theksoi gjithashtu se platformat si «Diaspora Flet» janë ato që na mundësojnë të forcojmë partneritetin me dhe mes diasporës për zhvillimin e mëtejshëm të vendit tonë, njëkohësisht përmirësimin dhe zhvillimin e komuniteteve të diasporës kudo që janë. Pas tij, Liza Gashi, zv. Ministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, prezantoi Kornizën e re të Angazhimit të Diasporës. Në një lidhje direkte me Zv. Kryeministren dhe Ministren e Punëve të

Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla-Schwarz, e cila tha se e kupton shumë mirë jetën në mërgatë dhe dëshirën e vullnetin e bashkatdhetarëve për të kontribuar në vendin amë. Në këtë drejtim, ajo shtoi se është duke u bërë një punë e madhe nga ana e qeverisë për të mundësuar kanalizimin dhe transferin e kapitalit njerëzor dhe financiar nga diaspora në Kosovë.

Karakterizuese e kësaj konference ishte fakti se shumica e folësve kërkuan përfshirjen pa vonesë të diasporës në të gjitha çështjet kanë të bëjnë me diasporën dhe me të gjitha zhvillimet në vendin amë. Sa i përket ruajtjes dhe kultivimit të gjuhës, identitetit dhe traditave pozitive si dhe modeleve funksional të diasporës, duhet tu referohemi më shumë bashkëkombësve tanë – Arbëreshëve në Itali!

Paneli bashkëveprues i shqiptaro-zviceranëve Emigrimi i të rinjve dhe «ikja e trurit»

Një prej shqetësimeve kryesore të të dy qeverive e shoqërive, si e Shqipërisë ashtu edhe e Kosovës – është patjetër «ikja e trurit». Prandaj, për këtë temë në lidhje me ikjen e të rinjve të talentuar dhe të shkolluar është diskutuar në ditën e dytë të Konferencës «Diaspora Flet». Tema e panelit ishte: «Emigrimi i të rinjve dhe «ikja e trurit»:

Çfarë mund të bëjmë për të trajtuar këtë fenomen?».

Panelistët kanë ndarë përvojat dhe njohuritë e tyre mbi tendencat aktuale dhe strategjitë që mund të ndikojnë në ndalimin e «ikjes së trurit». Për tu përballur sa më mirë me fenomenin folësit theksuan nevojën e dialogu gjithëpërfshirës e të gjithë akterëve relevantë, si: qeveria, punëdhënësit, punëmarrësit, shoqëria civile si dhe profesionistët nga diaspora.

Folësit e këtij paneli ishin: Ilir Gedeshi, drejtor i Qendrës për Studime Sociale; Ardiana Gashi, profesoreshë në Universitetin e Prishtinës; Osman Osmani, themelues i prointegra.ch; Marsela Ceno, kryetare e Shoqatës së Mjekëve Shqiptarë në Gjermani. Ky panel u moderua nga Hilmi Gashi, anëtar i bordit të GERMIN, politikan dhe veprimtar i mirënjohur shqiptaro-zviceran.

Pas 72 orëve, mbi 400 pjesëmarrësve, 74 folësve dhe 21 organizatave dhe institucioneve partnere e mbështetëse të Konferencës «Diaspora Flet» – pasditen e të shtunës, u mbyllë edicioni i tretë i konferencës. Ceremonia përmbyllëse u mbajt në Lapidariumin e Muzeut dhe u organizua me mbështetjen e Komunës së Prishtinës.

Pjesëmarrësit e Konferencës ditën e shtunë ishin mysafirë në ambientet e Kuvendit të Kosovës, ku çuditërisht, sikur edhe në ditët tjera të konferencës dhe në gjithë punimet e saj, munguan përfaqësuesit e subjekteve politike të Kosovës, ata të komisioneve parlamentare dhe të institucioneve e ministrive përkatëse që kanë të bëjnë edhe me diasporën. As një javë pas përmbylljes së konferencës «Diaspora Flet» 2023 në Prishtinë, anëtarë të komisionit për punë të jashtme e diasporë, ishin në Cyrih e Bernë të Zvicrës, ku takuan një grusht bashkatdhetarësh. Ata, përjashtojnë deputetët Arbëreshë Kryeziu Hyseni dhe Fitore Pacolli, nuk e panë të udhës të ishin prezent gjatë punimeve të konferencës as në vet Kuvendin e Kosovës, ku morën pjesë me qindra pjesëmarrës nga 18 vende të mërgatës sonë. Në punimet e konferencës munguan thuaja se të gjitha deputetët, anëtarët e grupet parlamentare si dhe ata të komisioneve parlamentare.

Impressum: **Bellage** zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | **Herausgeber** Verlagsgesellschaft work AG, Zürich | **Chefredaktion** Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne | **Chefredaktion** Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano | **Chefredaktion** Gianfranco Helbling | **Redaktionskommission** O. Osmani, E. Sariasslan, D. Filipović, M. Martin, M. Mendes | **Sprachverantwortlich** Osman Osmani | **Layout** I. Schieder, Unia | **Druck** CH Media Print AG | **Adresse** Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 16, osman.osmani@unia.ch

UNIA